



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d, dhe nenit 40, paragrafi 40.2, pika c të Ligjit nr. 03/ L – 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15 qershor 2008), dhe të dispozitave të nenit 34, paragrafi 34.1, pika d e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 – 391, të dt. 25.2.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 08.06.2016, merr këtë

V E N D I M

PËR

BARTJEN E BUXHETIT TË PASHPENZUAR NGA VITI 2015 NË VITIN 2016

I.

MIRATOHET Vendimi për bartjen e buxhetit të pashpenzuar nga viti 2015 në vitin 2016.

II.

Shuma e mjeteve të bartura, si në pikën I të këtij vendimi, është 7,280,641.27 €.

III.

Shuma e cekur në pikën II të këtij vendimi, destinohet si në vijim:

1. *Subvencione dhe transfere, shuma prej 100,000.00 €.*
2. *Investimet kapitale, shuma prej 7,180,641.27 €.*

IV.

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është edhe pjesa tabelare.

V.


Zbatimin e këtij vendimi do ta bëjnë Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Financave.

VI.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në web-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01. nr. 040-143806 ,më 10.06.2016

KRYESUESI I KUVENDIT TË KOMUNËS
Halim Halimi, jur. i dipl.



A r s y e t i m

Mbështetur në Ligjin e menaxhimit të financave publike dhe përgjegjësi dhe Ligjin mbi buxhetin, organizatat buxhetore realizojnë të drejtën për bartjen e mjeteve, si bilance të kontraktuara në vijueshmëri për realizim të projekteve kapitale.

Nga viti 2015 në vitin 2016, barten mjetet në shumë prej 7,280,641.27€.

Ndryshimet dhe bartja e mjeteve sipas fushave nga viti 2015 në vitin 2016, është orientuar në këto kategori ekonomike:

- **Subvencione dhe transfere** – mjete në shumë prej 100,000.00 €, të mbetura nga viti 2015.
- **Investime kapitale** - mjete në shumë prej 7,180,641.27 €, të mbetura nga viti 2015. Nga kjo vlerë, shumica janë projekte të kontraktuara në vitin 2015 dhe më herët, të cilat barten në vitin 2016. Disa projekte nga buxheti i vitit 2015 nuk janë realizuar, prandaj mjetet e planifikuara për këto projekte do të shpërndahen në projekte të tjera ekzistuese dhe në disa projekte të reja. Detajet për këto projekte janë të paraqitura në tabelat përcjellëse.